

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i Prokurimit: **Furnizim me AD-BLUE**

Sa i përket tenderit për: **TU-24-9473-1-1-1**

1.Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj **"POWER PLUS" SHPK**

NUI **810064858**

Adresa **Rr. "Përmeti" p.n.**

Vendi **RAHOVEC**

Kodi postar Numri **21000**

Telefonit **044 406 406**

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj **Bejtullah Deliu**

Adresa elektronike **powerplus.ks@gmail.com**

Data e parashtrimit të kërkesës **27.03.2025**



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	Nuk aplikohet
Adresa e plotë	Nuk aplikohet
Numri i Telefonit	Nuk aplikohet
Numri i faks-it	Nuk aplikohet
Adresa elektronike	Nuk aplikohet

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Lloji i kontratës:	Kontratë Publike Kornize - FURNZIM
Lloji i procedurës së prokurimit:	Procedure e HAPUR
Klasifikimi sipas vlerës:	Vlerë e MADHE, 200.000,00 Euro
Kriteri i dhënies së kontratës:	Tenderi i PËRGJEGJSHËM me çmimin më të ULËT
Publikim i Njoftimi për kontratë:	Me datën 11.09.2024 është bërë publikimi njoftimit për kontratë
Data e hapjes së tenderëve:	Më datën 04.11.2024 është bere data e hapja e tenderëve
Data e ngarkimit të “B58-Njoftim mbi vendimin e Autoriteti” kontraktues” dhe Letrat Standarde	Më datën 03.12.2024 autoriteti kontraktues ka ngarkuar “B58-Njoftim mbi Vendimin e AK”
Kërkesa për Rishqyrtim	Më datën 06.12.2024 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues
Pezullimi i aktivitetit të prokurimit:	Më datën 06.12.2024 autoriteti kontraktues ka pezulluar aktivitetin e prokurimit.
Vendimi i Autoritetit Kontraktues:	Më datën 09.12.2024 autoriteti kontraktues ka kthyer përgjigje, duke refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim.

Ankesa e parashtruar në OSHP	Më datën 17.12.2024 kemi parashtruar ankesë pranë OSHP-së.
Raporti i Ekspertit Shqyrtues	Më datën 24.12.2024 kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues të prokurimit.
Vendimi i PSH-OSHP-së	Me datën 14.02.2025 OSHP ka nxjerr vendimin nr.2024/1228, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, duke e kthyer ne rivlerësim.
Data e ngarkimit të “B58-Njoftim mbi vendimin e Autoriteti” kontraktues” dhe Letrat Standarde	Më datën 13.03.2025 autoriteti kontraktues ka ngarkuar “B58-Njoftim mbi Vendimin e AK”, hera e dytë.
Kërkesa për Rishqyrtim	Më datën 18.03.2025 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, hera e dytë.
Pezullimi i aktivitetit të prokurimit:	Më datën 18.03.2025 autoriteti kontraktues ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, , hera e dytë.
Vendimi i Autoritetit Kontraktues:	Më datën 21.03.2025 autoriteti kontraktues ka kthyer përgjigje, duke refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim, , hera e dytë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Më datën 18.03.2025 përmes platformës së e- Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues

Më datën 21.03.2025 kemi pranuar përgjigje nga autoriteti kontraktues ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim ku refuzon si të pa bazuar, por pa trajtuar të gjitha pretendimet tona ankimore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Vlerësojmë se janë shkelur dispozitat ligjore në vijim:

I. Informatat Sekrete Afariste, sipas nenit 11 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

II. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve sipas nenit 59 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, paragrafi 2 dhe 4.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

I. Informatat Sekrete Afariste, sipas nenit 11 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

Më datën **14.03.2025** kemi parashtruar kërkesë për qasje në informacione dhe dokumente të aktivitetit të prokurimit. Gjatë qasjes autoriteti kontraktues nuk ka ofruar qasje në plotë ndaj kërkesave tona;;

Kërkesa e jonë për qasje:

- *Konfirmimet e vazhdimet të vlefshmërisë së ofertave/tenderëve si dhe vazhdimet e SIGURIMIT të TENDEREVE për TE GJITHË OPERATORET EKONOMIK, si dhe dëshmitë e kohës së dorëzimit të tyre në platforme.*

sepse nuk na janë dhënë:

- Dëshmia e vazhdimet të sigurimit të tenderit për operatorin ekonomik **GETNO LLC; GRAMI ShPK; RGB ShPK, dhe Balkan Petrol Shpk.**
- Dëshmia e vazhdimet të vlefshmërisë së ofertës për operatorin ekonomik **Balkan Petrol Shpk.**
- Dëshmitë e vazhdimet të vlefshmërisë së ofertës dhe vazhdimet të vlefshmërisë së sigurimit të tenderit, për operatorët tjerë.

Autoriteti kontraktues duke vepruar në këtë mënyrë, mos dhënia e qasjes së plotë, neve si palë të interesit sipas kuptimit të paragrafit 1.26 të nenit 4, na ka pamundësuar vlerësimin më të detajuar të ofertës së tyre dhe kemi shumë dyshime se këta operatorë ekonomik janë të papërgjegjshëm si

rezultat i mosplotësimit të kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit dhe mos dorëzimit të dëshmimeve përkatëse edhe gjatë “sqarimeve”.

II Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve sipas nenit 59 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, paragrafi 2 dhe 4.

Autoriteti kontraktues, gjegjësisht personat përgjegjës, gjatë ri-vlerësimit të ofertave nuk kanë vlerësuar drejt duke shkelur nenin 59 të LPP-se, edhe përkundër faktit se tashmë kanë pasur një vlerësim të konstatimit tonë nga ana e **ekspertit shqyrtues** në raportin e tij për rastin me numër **2004/1228**, por edhe një kërkesë nga **Paneli Shqyrtues** që të verifikoj edhe njëherë referencat e anëtareve të grupit sipas të gjeturave të ekspertit shqyrtues, edhe përkundër se verifikimi nuk besojmë që gjen diçka ma tepër sepse nuk mund ta ndryshoj natyrën e furnizimeve të kryera, autoriteti kontraktues;

Komisioni vlerësues **PËRSERI** kanë konsideruar si të përgjegjshëm Grupin e operatorëve ekonomik **GETNO LLC; GRAMI ShPK; RGB ShPK**, derisa nuk plotëson kërkesat mbi **Aftësitë Teknike dhe/ose Profesionale**; sepse:

- **Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale** – sipas listës se furnizimeve të ofruara nga GETNO LLC shihet se aty ka vetëm ujë të distiluar e që është në kuadër të ngjashmërisë se furnizime të kërkuara likuide e që përdoren në automjete (fusha e automobilistikës), por nuk arrijnë vlerën prej **300,000.00 Euro**, në **3 (tri)** vitet e shkuara. Ndërsa kontratat e furnizuara për KEK si;” Furnizim me Feri Sulfat” dhe “Furnizim me rrëshirë”, nuk kanë të bëjnë me as për së afërmi me natyrën e furnizimeve të kërkuara, janë thjesht kimikale. Përderisa disa kontrata tjera për shumicën e të cilave nuk ka pranime apo referenca sipas kërkesës se autoriteti kontraktues (*....bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.*), por thjesht kanë të bëjnë me furnizime me ngjitës, gëlqere ose edhe kimikate tjera, por që nuk kanë ndonjë ndërlidhje me kërkesat e autoritetit kontraktues.

Duke u nisur nga dokumentet e pranuar gjatë qasjes kemi kuptuar se mungojnë Dëshmitë për kërkesat e parashtruara nga autoriteti kontraktues për këtë grup të operatorëve ekonomik:

Pas pranimit të vendimit nga Paneli Shqyrtues, të datës 14.02.2025, me nr. 2024/1228, kërkojmë sqarime shtesë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, vecanërisht për listat e dorëzuara të kontratave dhe referencat. Ju lutem, sqaroni me dokumente zyrtare kohën e përfundimit të këtyre kontratave, si dhe ofroni një dëshmi që tregon se këto furnizime janë të natyrës së ngjashme me aktivitetin e prokurimit.

Si përgjigje ndaj kësaj kërkesë të autoritetit kontraktues, GETNO LLC, ka dorëzuar një “sqarim” i cili në përmbajtjen e vet ngjashmërinë e përshkruan si në vijim:

Çdo kimikat industrial në formë të lëngshme, me përbërje të përcaktuar, mund të konsiderohet i ngjashëm në aspektin e **përpunimit, ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes**.

Ky “sqarim” nuk është se afërmi me opinionin e KRPP, datë **09.06.2023** lidhur me furnizimet e ngjashme, sepse nuk i takojnë kategorisë së njëjtë të FPP siç është përcaktuar nga autoriteti kontraktues në dosje të tenderit, asaj 23000000-7 (Petroleum products and fuels), sepse operatori ekonomik flet për procesin e përpunimit, ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes, madje e ka theksuar, përderisa autoriteti kontraktues ka kërkuar furnizime të ngjashme.

Madje nuk ka dorëzuar **ASNJË DËSHMI** siç ka kërkuar autoriteti kontraktues në kërkesën e tyre për sqarime.

- **Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale** (Deklarata e nënshkruar mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik) – sipas deklaratës së lëshuar nga ky grup i operatorëve ekonomik shihet se këta kanë dhënë një deklaratë për **produkt ekuivalent** dhe jo sipas parametrave të standardit të kërkuar, duke e vënë autoritetin kontraktues në lojë zgjedhje. Ky furnizim ekuivalent sikur të ndodhë do shkaktonte defekte teknike deri në mos

Ne zotohemi se malli i ofruar nga ne përputhet dhe **është ekuivalent** me të gjitha specifikacionet teknike të përmendura nga Autoriteti Kontraktues në Aneksin 1.

funksionim të flotës së automjeteve.

Shënim: Lidhur me kërkesat rreth produktit sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit, ku kërkohet “*AD BLUE Aditivi ti përgjigjët standardit ISO 22241 dhe produkti të jetë i licencuar nga VDA*”. Shqetësuese është, përderisa në ofertë nuk ka ndonjë autorizim të furnizimit nga lëshuesi i certifikatës VDA apo ndonjë prodhues tjetër i AD BLUE e që siguron se furnizimet do jene ne përputhje me standardin e kërkuar, sidomos fjala “ekuivalent” tek deklaratat e përputhshmërisë së specifikave teknike.

Këtu mungon autorizimi nga furnizuesi (prodhuesi i AdBlue, meqë vet nuk është as prodhues dhe as i autorizuar për te prodhuar AdBlue), dhe kjo sqaron më së miri, pse në ofertën e tyre kanë cekur “**..është ekuivalent**”

Si, rrjedhojë e këtyre të gjeturave ky grup i operatoreve ekonomik **PËRSERI** edhe pas rivlerësimit nuk plotëson kërkesat e Aftësive Teknike dhe/ose Profesionale dhe duhet të konsiderohet i pa përgjegjshëm edhe për këto arsye.

Duke u nisur nga dokumentet e pranuar gjatë qasjes kemi kuptuar se mungojnë edhe disa dëshmi që kanë të bëjnë me **Kërkesat Administrative** siç janë:

- Mungesa e vazhdimit të sigurimit të tenderit.
- Mungesa e dëshmimeve lidhur me sqarimet e kërkuara.
- Mungesa e vlefshmërisë së tenderëve për tërë periudhën dhe sigurimit të tenderit, sepse
 - Data e hapjes së tenderëve ka qenë; 04.11.2024.
 - Data e skadimit të vlefshmërisë së ofertave ka qenë (90 ditë): 02.02.2025.
 - Data e kërkesës për zgjatje të afatit të vlefshmërisë së ofertave nga AK: 29.01.2025
- Data e konfirmimit nga GETNO LLC, data 30.01.2024 duke deklaruar se ofertë është 60 dite nga data 31.01.2025, por oferta e tyre mbetet me vlefshmëri prej **58 ditëve** nga data e skadimit të vlefshmërisë që është data 02.02.2025.

Shënim: nuk ka dëshmi se e njëjta është ngarkuar në platformën e e-prokurimit, që len dyshim se është dorëzuar ma vonë, jashtë afatit. Shpresojmë që të dëshmoni në përgjigjen tuaj (AK-së).

- Data e skadimit të vlefshmërisë së sigurimit të tenderëve sepse afati ka qenë (120 ditë): deri më datën 04.03.2025.
- Andaj Grupit të operatorëve ekonomi përfaqësuar nga GETNO LLC iu **mungon** dëshmia e vazhdimit të vlefshmërisë së sigurimit të tenderit që duhet të jete, plus 30 ditë nga data e fundit e vlefshmërisë së tenderit/ofertës, sipas neni 28.6 të Rregullores për Prokurim Publik, citati:

“28.6 Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit.”

Sqarime në përgjigjet e autoritetit kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Gjatë qasjes autoriteti kontraktues na ka ofruar një dokument “Police Sigurimit” i lëshuar nga KS Prisig, i cili mban datën 04.03.2025 dhe që është dokument i lëshuar pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave. Po ashtu, nuk ka dëshmi se si është dorëzuar, pasi që në platformën e e-prokurimit duket që mungon një dëshmi e ngarkimit të tij brenda afatit.

Mungesa e sigurimit të tenderit të vazhduar shpërfaqet edhe në raportin e rivlerësimit të tenderëve, ku **ASNJE** nga operatorët ekonomik tjerë nuk kanë vazhduar vlefshmërinë e sigurimit të tenderit, përveç neve.

Shih në vijim pjesë nga raporti i rivlerësimit. Pyetja parashtrohet si na qenkan të përgjegjshëm këta dy operatorë ekonomik (GETNO LLC etj., dhe Ballkan Petrol ShPK).

Siguria e tenderit					
	TENDERUESI	Forma e sigurisë së tenderit	Vlera e sigurisë së tenderit	Sigurimin e tenderit të vlefshëm derime	Emetuesi e sigurisë së tenderit
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik GETNO L.L.C.; RGB SH.P.K.; Grami SH.P.K. Rr.Imzot Nikprelaj, Ulpianë, Prishtina	Bondi te sigurisë, të lëshuar nga një kompanie sigurimit	2,000.00 EUR	04.03.2025	K.S.PRISIG
2.	" Ballkan Petrol " SH.P.K. Zona Industriale Gërlicë, Ferizaj 810080036	Bondi te sigurisë, të lëshuar nga një kompanie sigurimit	EUR	09.03.2025	K.S SIGAL
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik POWER PLUS SH.P.K.; N.T. „Fer-Petroll RR. Permeti pn, Rahovec	Bondi te sigurisë, të lëshuar nga një kompanie sigurimit	2,000.00 EUR	12.05.2025	K.S ELSIG

Ndërsa, në raport me operatorin ekonomik **Ballkan Petrol ShPK**, autoriteti kontraktues ka marrë përsipër **PËRSËRI** të bëjë korrigjim të ofertës duke prekur çmimin për njësi i cili ndikon në çmimin total të ofertës së tij, kjo vërehet tek “B58-Njofim mbi Vendimin e autoritetit kontraktues” të ngarkuar në platformën e e-prokurimit më datën 03.12.2024 dhe atë të datës 13.03.2025, ku autoriteti kontraktues paraqet ofertën e këtij operatori ekonomik me shumë prej 101.694,92 euro.

6.	" Ballkan Petrol " SH.P.K. Zona Industriale Gërlicë, 70000, Ferizaj	101694.92
----	---	-----------

Ku në fakt çmimi i ofruar sipas “përshkrimit të çmimit” për njësi është 0.48 euro për litër, ndërsa çmimi total për 250000 litra është 120.000,00 euro.

FORMALARI I PËRSHKRIMIT TË ÇMIMEVE					
Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
1	Furnizim me AD BLUE	litër	250 000.00	0.48	€ 120 000.00
				TOTALI I OFERTËS ME TVSH	€ 120 000.00

Nga Përshkrimi i çmimit, të dorëzuar nga Ballkan Petrol ShPK shihet se nuk bëhet fjalë për ndonjë gabim aritmetikor!?

Gjithashtu shuma totale sipas “Formularit të tenderit” është 120.000,00 euro

1 Furnizim me AD-BLUE	
3. Çmimi total i tenderit është:	120,000.00 EUR

Autoriteti kontraktues duke provuar çdo mënyrë për të arsyetuar/argumentuar përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik dhe renditjen e tij më lart, kanë harruar se një ndryshim i çmimi nga 120.000,00 euro në 101.694,93 euro, do të tejkalon 2% të vlerës së gabimit të lejuar, nëse autoriteti kontraktues do ta trajtonte këtë si korrigjim aritmetikor sipas nenit 59.3 të LPP-së ose 40.9, pika b e Rregullores.

Ose nëse autoriteti kontraktues do ta pranonte këtë si shumë totale, do ndodhej para situatës se mospërputhjes së çmimit total në Formularin e Tenderit dhe Totalit të Përshkrimit të Çmimit. Atëherë do duhet të eliminonte ofertën e Ballkan Petrol-it sipas nenit 40.10 pika b, e Rregullores.

40.10 Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:

- a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;
- b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Sqarime në përgjigjet e autoritetit kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Autoriteti kontraktues në këtë pikë ka deklaruar se:

“Po ashtu, dëshirojmë të sqarojmë se shqetësimet tuaja në lidhje me operatorin ekonomik Ballkan Petrol ShPK janë të pabaza, pasi ky operator nuk është palë në këtë rast.”

Anomalia e kësaj është se autoriteti kontraktues thjesht gënjen, derisa sipas deklaramit të mësipërm autoriteti kontraktues e konsideron si të përgjegjshëm dhe përmes “Letrave Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm” e cilëson si operator ekonomik të pasuksesshëm!!!!?

Kjo deklaratë e autoritetit kontraktues tregon qartë se ata nuk e kanë idenë se me çfarë janë duke vepruar ligjërisht, por mendjen e kanë kthyer tek GETNO LLC; GRAMI ShPK; RGB ShPK, se nga operatori ekonomik Ballkan Petrol ShPK kanë hequr dorë se siç duket nuk e ka vazhduar vlefshmërinë e ofertës, pasi që autoriteti kontraktues nuk ka ofruar asnjë dëshmi gjatë qasjes që kemi pasur.

Andaj, duke u nisur nga dëshmitë e pranuar gjatë qasjes të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës (përfshirë neve si palë ankuese), janë edhe administrativisht të papërgjegjshëm, për faktin se nuk kanë vazhduar vlefshmërinë e tenderëve brenda afatit, ose vlefshmëria e tyre nuk është e plotë siç është rasti me grupin e operatorëve ekonomik GETNO LLC; GRAMI ShPK; RGB ShPK, ku

deklarata e tyre mbulon vetëm një periudhë prej 58 ditëve nga data e skadimit të vlefshmërisë paraprake.

KËRKESË PËR ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Andaj në ndërlidhje me këto veprime, parashtojme kërkesë që Organi Shqyrtues i Prokurimit, bazuar në nenin 91 të Rregullores të inicioj revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit, sepse Zyrtari përgjegjës i prokurimit është në shkelje të rënda të ligjit sipas nenit 97 (Shkeljet e rënda), paragrafi 1 Rregullores dhe atë për pikat e mëposhtme:

c. Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kriterëve apo dëshmime jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njësisë së kërkesës.

Për vëmendjen e OSHP-së: Autoriteti kontraktues nuk ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruar në kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 18.03.2025.

Prandaj, duke u nisur nga provat dhe argumentet e shtjelluara më sipër propozojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të nxjerr:

VENDIM *(Res judicata)*

- Të anulohet B58-Njoftim mbi Vendimin e autoritetit kontraktues”, dt. 13.03.2025
- Të konsiderohet SI TË BAZUAR ankesën tonë dhe të kthehet në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit.
-

9. Dëmet materiale

Shkeljet e mësipërme pritet të shkaktojnë dëm material financiar dhe të cilat dëme do të precizohen në varësi të veprimeve që autoriteti kontraktues pritet të ndërmarr në raport me këtë ankesë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

1. Përgjigja e autoriteti kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim
2. Sqarimi i dhënë nga operatori ekonomik GENTO LLC, gjatë fazës së ‘Ri-vlerësimit’!?
3. B58-Njoftim Mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues, datë 13.03.2025, ku shihet se Ballkan Petrol ShPK, ka marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.
4. Proces verbali i Hapjes së Tenderëve, ku shihet se Ballkan Petrol ShPK, ka marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.
5. Raporti i rivlerësimit
6. I gjithë dokumentacioni tjetër i procedurës dhe dëshmitë që lidhen me deklaratimet tone gjenden e platformën elektronike te prokurimit.

VLERËSIMI I BËRE NGA GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK ANKUES.

		POWERPLUS SHPK/ FER PETROLL	GETNO/GRAM I/RGB	BALLKAN PETROL SHPK
Çmimi i ofertës/tenderit sipas Formuarit te Tenderit dhe Përshkrimit të çmimit		107.500,00	80.000,00	120.000,00
PËRSHTATSHMËRIA ADMINISTRATIVE E TENDERËVE				
Kërkesat administrative:	Dëshmia e kërkuar dokumentare			
Deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Deklaratë	Në pajtim	Në pajtim	Nuk aplikohet
Deklaratë e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Deklaratë	Në pajtim	Në pajtim	Nuk aplikohet
Deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Deklaratë	Në pajtim	Në pajtim	Nuk aplikohet
Formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe i nënshkruar si duhet	Formulari i tenderit, pjese e dosjes së tenderit	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Sigurimi i tenderit: PO Vlera e sigurisë së tenderit 2.000,00 euro Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120	Aneksi 4, i dosjes se tenderit i plotësuar dhe lëshuar nga kompani e sigurimeve ose institucion tjetër financiar/bankar	Në pajtim	NUK është në pajtim	NUK është në pajtim

Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë dite	Informatë nga "Formulari i Tenderit"	Në pajtim	NUK është në pajtim	NUK është në pajtim
PRANUSHMËRIA E TENDERUESVE				
Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare			
Deklarata nen betim	Deklarata e nënshkruar nën betim në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-92.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE				
Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare			
Certifikatës së Numrit unik të biznesit, së bashku me përshkrimin e veprimtarisë primare dhe sekondare Kopja e Certifikatës TVSH-se.	Kopja e Certifikatës së Numrit unik të biznesit Certifikata e Regjistrimit për TVSH	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
GJENDJA EKONOMIKE DHE FINANCIARE				
Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare			
Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të shkuara (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) një xhiro	Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e shkuara (2021,2022,2023) ose vërtetim të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK-ja mbi qarkullimin financiar në tri vitet	Në pajtim	Nuk është në pajtim	Në pajtim

totale ne EURO të barabartë ose më shumë se 400,000.00 € .	e shkuara ose gjendje e përgjithshme të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK. Ose Kopjet e raporteve financiare nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.			
AFTËSIA TEKNIKE DHE/OSE PROFESIONALE				
Kapaciteti teknike dhe profesional	Dëshmia e kërkuar dokumentare			
Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizime në vlerë minimale prej 300,000.00 € Euro , në 3 (tri) vitet e shkuara (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).	Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.	Në pajtim	Nuk është në pajtim	Në pajtim.
Deklarata mbi specifikimet teknike (edhe sipas 3.1 të FTD-së)	Deklarata e nënshkruar mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik	Në pajtim	Nuk është në pajtim*	Në pajtim
Deklarata për afatin e liferimit.	Operatori ekonomik duhet të ofrojë një deklaratë të nënshkruar dhe vëlosur ku merr përgjegjësi se AD BLUE do të liferohen brenda 2 dite kalendarike nga data e urdhërporosisë nga AK	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

OE duhet të prezantoj Certifikatën e produktit për produktin e kërkuara.	OE duhet të prezantoj Certifikatën e produktit për produktin e kërkuara.	Në pajtim	Nuk është në pajtim	Në pajtim
Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në pronësi të paktën një automjet për bartjen transportin e AD-BLUE për realizim e kësaj kontrate	Listën e mjetit transportues për realizimin e kontratës se bashku me kopjet valide të librezave të regjistrimit të automjeteve.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
PERGJEGJSHMERIA E OPERATOREVE EKONOMIK		PO	JO	JO

Gjetjet sipas vlerësimit tonë:

Grupi i operatoreve ekonomik **POWERPLUS ShPK dhe FER PETROLL**

Grupi i operatoreve ekonomik **POWERPLUS SHPK dhe FER PETROLL**, ka plotësuar të gjitha kërkesat e përzgjedhjes të parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë nga autoriteti kontraktues. Çka është konstatuar nga PSH dhe vet autoriteti kontraktues gjatë fazës së ri-vlerësimit.

Grupi i operatoreve ekonomik **GETNO LLC; GRAMI ShPK; RGB ShPK**

Grupi i operatoreve ekonomik **GETNO; GRAMI; RGB** nuk ka plotësuar kërkesat lidhur me **Aftëstë Teknike dhe/ose Profesionale** dhe **Kërkesat Administrative**, sepse:

- **Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale** (Referencat) – sipas listës së furnizimeve të ofruara nga GETNO LLC shihet se aty ka vetëm ujë të distiluar e që është në kuadër të ngjashmërisë së furnizimeve të kërkuara likuide e që përdoren në automjete (fusha e automobilistikës), por nuk arrijnë vlerën prej **300,000.00 Euro**, në **3 (tri)** vitet e shkuara. Ndërsa kontratat e furnizuara për KEK si;” Furnizim me Feri Sulfat” dhe “Furnizim me rrëshirë”, nuk kanë të bëjnë me as për së afërmi me natyrën e furnizimeve të kërkuara, janë thjesht kimikale. Përderisa disa kontrata tjera për shumicën e të cilave nuk ka pranime apo referenca sipas kërkesës së autoriteti kontraktues (*...bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.*), por thjesht kanë të bëjnë me furnizime me ngjitës, gëlqeres ose edhe kimikate tjera.

- **Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale** (Deklarata e nënshkruar mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik) – sipas deklaratës së lëshuar nga ky grup i operatorëve ekonomik shihet se këta kanë dhënë një deklaratë për **produkt ekuivalent** dhe jo sipas parametrave të standardit të kërkuar, duke e vënë autoritetin kontraktues në lojë zgjedhje. Ky furnizim ekuivalent sikur të ndodhë do shkaktonte defekte teknike deri në mos funksionim të flotës së automjeteve.

Shënim: Lidhur me kërkesat rreth produktit sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit, ku kërkohet “*AD BLUE Aditivi ti përgjigjet standardit ISO 22241 dhe produkti të jetë i licencuar nga VDA*”. Shqetësuese është, përderisa në ofertë nuk ka ndonjë autorizim të furnizimit nga lëshuesi i certifikatës VDA apo ndonjë prodhues tjetër I AD BLUE e që siguron se furnizimet do jene ne përputhje me standardin e kërkuar, sidomos fjala ‘ekuivalent’ tek deklaratat e përputhshmërisë se specifikave teknike. Pra **mungon autorizimi** nga furnizuesi (prodhuesi i AdBlue, meqë vet nuk është as prodhues dhe as i autorizuar për të prodhuar AdBlue)

- **Kërkesat Administrative**, nuk ka plotësuar vlefshmërinë e tenderit duke pas parasysh se ka bërë zgjatjen nga data 31.01.2025 për 60 ditë, e që në fakt është dashur ta beje nga data e skadimit që ka qenë data 02.02.2025, d.m.th. oferta e tyre ka vlefshmëri vetëm **58 ditë**, dhe nuk ka asnjë dëshmi në platformën e e-prokurimit të jetë dorëzuar brenda afatit
- **Kërkesat Administrative**, në ofertën e tij mungon vazhdimi i sigurimit të tenderit dhe nuk ka asnjë dëshmi në platformën e e-prokurimit të jetë dorëzuar brenda afatit.

BALLKAN PETROL SHPK

Operatori ekonomik **BALLKAN PETROL SHPK**, nga dëshmitë e ofruara gjate qasjes konstatojmë se ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm, sepse nuk ka dëshmi se është vazhduar vlefshmëria e ofertës dhe e sigurimit të tenderit nga ky operator ekonomik brenda afati sipas kërkesës se autoritetit kontraktues.

Por, nisur nga “B58-Njoftim mbi Vendimin e AK” datë 13.03.2025 dhe letrat standarde shihet se autoriteti kontraktues ka prekur ofertat/çmimet e ofertave të disa operatorëve ekonomik, madje disa operatorë ekonomik i konsideron të përgjegjshme, por të pasuksesshëm edhe përkundër faktit se nuk ka dëshmi se të njëjtët kanë vazhduar vlefshmërinë e ofertave dhe sigurimit të tenderëve. Argumentet janë më sipër në kërkesën